



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 13 Prill 2021

Nr: 231

VENDIM

PËR

MIRATIMIN E GAZETARËVE DHE OPERATORËVE TË KORPORATËS AUSTRIAKE TË TRANSMETIMIT (ORF), ALBANIAN POST, STAR PLUS TELEVISION, REUTERS, GAZETA ORA (FIRST NEWS MEDIA NETWORK), EURONEWS ALBANIA DHE MATI TV, PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË TË DATËS 25 PRILL 2021.

Në mbështetje të neneve 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 2, datë 02.02.2021 “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjektet zgjedhore”, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

VENDOS:

1. Të miratojë kërkesën e Korporatës Austriake të Transmetimit (ORF) për akreditimin e 6 (gjashtë) gazetarëve për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 Prill 2021, sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të miratojë kërkesën e Albanian Post për akreditimin e 18 (tetëmbëdhjetë) gazetarëve për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 Prill 2021, sipas lidhjes 2 bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Të miratojë kërkesën e Star Plus Televizion për akreditimin e 22 (njëzet e dy) gazetarëve për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 Prill 2021, sipas lidhjes 3 bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Të miratojë kërkesën e REUTERS për akreditimin e 4 (katër) gazetarëve për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 Prill 2021, sipas lidhjes 4 bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Të miratojë kërkesën e Gazeta Ora (First News Media Network) për akreditimin e 2 (dy) gazetarëve për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 Prill 2021, sipas lidhjes 5 bashkëlidhur këtij vendimi.
6. Të miratojë kërkesën e EuroNews Albania për akreditimin e 58 (pesëdhjetë e tetë) gazetarëve për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 Prill 2021, sipas lidhjes 6 bashkëlidhur këtij vendimi.
7. Të miratojë kërkesën e “Mati TV” për akreditimin e 7 (shtatë) gazetarëve për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 Prill 2021, sipas lidhjes 7 bashkëlidhur këtij vendimi.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
9. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Ilirjan CELIBASHI